Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES¹

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e

mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) Nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) Nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) Nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) Ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1.Objekti i Ndertimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.

2.1.2.Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, në marrëveshjen e

noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht, duhet të përcaktohen saktë përqindja e pjesëmarrjes së punës / shërbimit / furnizimit dhe elementet konkrete për secilin zë të preventivit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore gjate tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit duhet të jetë jo me pak se 50 % e vleres limit te kontratës që prokurohet. Kjo do te vertetohet duke paraqitur vertetim per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit, leshuar nga administrata tatimore.

2.2.2. Kopje te certifikuara te bilanceve tre viteve te fundit (2017),(2018), (2019), te konfirmuar nga organi kompetent.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitet 2018 , 2019, 2020 sipas ekstraktit te thjeshte dhe historik te QKB-se. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Bashkia.

2.2.4. Deklarate e OE qe nuk ka asnje detyrim te pa likujduar, te cfaredo natyre, ndaj Bashkise Malesi e Madhe. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikoje vërtetësinë e deklaratës.**

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

a. License profesionale sipas modelit të leshuar nga Ministria perkatese, sipas legjislacionit ne fuqi, e vlefshme me kategorite:

- NP- 1 B
- NP- 2 A
- NP-3 A
- NP- 4 B
- NP- 5 B
- NP- 7 E
- NP-11 A
- NP-12 A

- NS-1 A
- NS-4 A
- NS- 6 A
- NS- 8 A
- N.S. 16 A
- NS- 18 A

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë perkatese sipas legjislacionit ne fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2.3.2 Ofertuesi duhet te jete i pajisur me Certifikate:

ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)
ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)
OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
PAS 99: 2012 (Sistemi i menaxhimit të integruar)
ISO 50001:2018 (Sistemi i menaxhimit të energjisë)
ISO 39001:2012 (Certifikate për sistemin e menagjimit të sigurisë në trafikun rrugor)
ISO 3834-2: 2005 (Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike)
ISO 1452-1:2009 (Sistemi i tubacioneve plastike);
SA 8000:2014 (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore);
ISO 28001:2007 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit);
BS EN 13331-1 2002(Sistemet per veshjen e kanaleve);
ISO 50001:2011 (Sistemi i menaxhimit të energjisë);
ISO EN 3834-2:2006 (Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike);
Certifikatat duhet te jene ne gjuhen e ofertes, dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen.
Ne rast bashkimi operatoresh, keto certifikata duhet ti kete secili operator ekonomik ne baze te perqindjes se punimeve qe merr perisiper ne akt-marreveshje.

2.3.3 Ofertuesi duhet te kete një punësim mesatar jo me pak se 85 (tetedhjetepese) punonjes (numer i nevojshem dhe i mjaftueshem per kryerjen e punimeve ne kohe, sipas analizes, bazuar ne preventivin dhe grafikun e punimeve) , per periudhen Gusht 2019 - Korrik 2020. Kjo do te vertetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen perkatese;

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

2.3.4 Ofertuesi duhet te kete drejtues teknik ne licencen e zbatimit te punimeve, te pakten:

- 1) Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- 2) Inxhinier Topograf 1 (nje)
- 3) Inxhinier Elektrik 1 (një)
- 4) Inxhinier Mekanik 1 (një)
- 5) Inxhinier Ndertimi, profili Gjeoteknik 1 (një)

Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të pakten periudhën Gusht 2019 - Korrik 2020. Për secilin duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), CV dhe Libreze pune.

2.3.4.1 Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jetë i përfshire në licensën e shoqërisë, dhe të deklaroje se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, si dhe nuk eshte i punesuar ne institucione tjera shteterore apo private, shoqëruar me

Dokumenta Standarde të Tenderit

dokumentacionin e mëposhtem: Kontrate pune e noterizuar (e vlefshme), Diplome, CV sidhe libreze pune. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj deklaratën për përcaktimin e drejtuesit teknik të punimeve).

2.3.5 Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 30 punonjës të kualifikuar, nga të cilët të paktën:

- 1 (një) Elektriçist
- 1 (një) Mekanik
- 1 (një) Karpentier
- 1 (një) Specialist Ndërtimi
- 1 (një) Montator
- 1 (një) Murator
- 1 (një) Bojaxhi

Per keta te paraqitet kontrata e punes, Certifikata e Trajnimit, Dëshmia e Kualifikimit te sigurimit teknik.

- 7 (shtate) Specialist per montim tubash HDPE, shoqëruar me kontratë pune, Certifikatë Trajnimi.
- 1 (një)teknikNdertimi, shoqëruar me kontratë pune, Liçenseprofesionalenezbatimnga
- 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilët 2 (dy) automakiniste dhe 4 (dy) eskavatoriste, per te cilet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse

Punonjesit duhet të jenë të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për të pakten vitin e fundit.

2.3.6. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

1(një) inxhinier drejtues teknik, i cili të jetë i çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

1(një) punonjes specialist ekspert zjarrfikës në fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, dëshmuar me kontrate pune dhe çertifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH.

1(një)Inxhinier Auditues i Energjisë(i pajisur me çertifikatë për auditimin e energjisë), e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Stafi i mesiperm duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit dhe te paraqitet per ta kontrata e punes dhe certifikatat perkatese.

2.3.7.OE ofertues duhet te disponoje per mallrat e meposhtme:

- a) Tuba HDPE– Fabrike prodhimi/qera/kontrate furnizimi.

Per tubat HDPE , nese ka kontrate qiraje ose furnizimi te paraqitet kontrata perkatese, e cila duhet te jete e vlefshme deri ne perfundimin e plote te punimeve. Kontrata duhet të përmbaje certifikatën

Dokumenta Standarde të Tenderit

e origjinës së mallit, katalogje, broshure etj., si dhe të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit / prodhuesve për tubo HDPE të jetë në përputhje me standartin industrial ISO 9001:2015. Katalogët duhet të paraqiten së bashku me dokumentet e tjera në gjuhën shqipe ose angleze. Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë noteriale shërbimi me një laborator testimi të materialeve të ndertimit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose nderkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizat e cmimeve për të gjithë zerrat e preventivit me analize, plan – organizimin dhe metodologjinë e punimeve në objekt sipas kërkesave të përcaktuara nga KTP dhe KTZ në fuqi.

2.3.11. OE ofertues duhet të ketë Licence për Mbrojtjen nga Zjarri (**Kodi 1.2.A**).

2.3.12. OE ofertues duhet të ketë licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me Kodin III.2.A. “License për Ekspertizë dhe Mbrojtje në Mjedis”.

2.3.13. OE ofertues duhet të ketë Licence për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane **Kodi III.2.B**.

2.3.14. Dëshmi për makinerite dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 10), për makinerite dhe pajisjet e mëposhtme (ne pronësi ose me qera):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min. 25 ton.	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min. 13-15 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Pompë uji	7 copë	Pronësi ose me qera
Depozite Uji 5000 lit	4 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine deri në 3.5 Ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	5 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator 4-5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Damper / minidamper	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul	2 copë	Pronësi ose me qera
Freze	1 copë	Pronësi ose me qera
Bobcat i paisur me Fshese asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

Cekic pneumatik	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat per saldimin me electrofusion deri DN 600	10 copë	Pronësi ose me qera
Aparatura per bashkim tubacionesh me metoden “BUTT FUSION JOINT” PE deri DN 600	3 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak për ngjeshje dheu	10 copë	Pronësi ose me qera
Moto/Gjenerator	10 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	3 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	3 copë	Pronësi ose me qera
Tranxhe hekuri	1 copë	Pronësi ose me qera
Perzjeres llaci	10 copë	Pronësi ose me qera
Trapane	1 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier për zyra	3copë	Pronësi ose me qera
Pajisja per testimin e presionit të ujit (Përbëre nga pompa manuale e presionit, sensor për matjen e temperatures, sensor për matjen e presionit, ekranin) (Pajisja digitale të shoqërohet me foto dhe catalog)	3 copë	Pronësi ose me qera
Instrument i kombinuar për PH, Ocugen, Temperaturën, Trazimin dhe mbetjet e klorit(Pajisja digitale të shoqërohet me foto dhe catalog)	3 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes / prurjes(Pajisja digitale të shoqërohet me foto dhe catalog)	3 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike prodhim betoni jo me larg se 60 km nga objekti	1 copë	Pronësi / qera / kontrate furnizimi
Fabrike asfalto-betoni e pajisur me Leje Mjedisore nga QKL jo me larg se 60 km nga objekti	1 copë	Pronësi / qera / kontrate furnizimi

Gjithashtu, duhet të paraqiten mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 10 copë.
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 10 dhe dokumentacioni si më poshtë:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të

Dokumenta Standarde të Tenderit

qerese, e vlefshme vetem për këtë objekt. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga përfaqesuesi i shoqërisë ofertuese).
- f) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjate afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të saktësojë vendndodhjen e mjeteve, me qëllim që të mundësojë AK verifikimin e tyre në rast se lind nevoja.

2.3.15. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e tenderit.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:

- Kontrate punimesh
- Situacionin përfundimtar
- Akt marrjen në dorëzim (e perkohshme)
- Akt Kolaudimi i Objektivit
- Formular Vlerësimi

Per kontratat me subjekte private duhet të paraqitet: Kontrate, Situacion, Aktkolaudimi, fature tatimore shitjeje dhe Vertetimin e realizimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në piken 1/a, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.16 Kandidatët/ofertuesit duhet të paraqesin vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

2.3.17 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për materialet / pajisjet: flanaxhë adaptor, rakorderi, pjese special gize, saraçineska, mates uji, Ti Elektro Fuziv, Spindles, Hydrant.

Për këto materiale, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori. Katalogët duhet të paraqiten së bashku me dokumentet e tjera në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duhet të paraqitet për prodhuesin / distributorin çertifikata ISO 9001:2008/2015. Shënim: Operatori ekonomik /Bashkimi i operateve, duhet të ofertojë vetëm me një prodhues për secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose më shumë prodhues për të njëjtin artikull, përbëjnë objekt s'kualifikimi nga procedura. Prodhuesi i këtyre materialeve duhet të jetë i çertifikuar sipas RAL-GZ 662 nga instituti ndërkombëtar GSK, për lyerjen e shtresës së jashtme të rakorderive me bojë epoksi pluhur me mbrojtje nga korrozioni.

2.3.18 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

2.3.19. Operoret e huaj ekonomike, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

2.3.20. Grafiku i Punimeve sipas të gjitha zërave të preventivit.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Dokumenta Standarde të Tenderit

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 16

[*Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të duktshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

